

VENDIM
Nr.567, datë 28.5.2009

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, PËR QENDRËN
KOMBËTARE TË LICENCIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 29 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009” dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për Qendrën Kombëtare të Licencimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, t’i shtohet fondi 34 000 000 (tridhjetë e katër milionë) lekë, përkatësisht:

- 21 000 000 (njëzet e një milionë) lekë, zëri “Shpenzime personeli”;
- 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë, zëri “Shpenzime korente”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2009.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha